



**Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo**

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës

Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



KUVENDI I KOMUNËS SË MAMUSHËS

**RR E G U L L O R E
PËR**

TATIM NË PRONËN E PALUAJTHSHME PËR VITIN 2015

Mamushë Shtator 2014

Në bazë të dispozitave të nenit 9 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr. 03/ L – 049, të dispozitave të nenit 17 të Ligjit për vetëqeverisje lokale 03/ L - 40, nenit 9 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049, neneve 2,6,7 e 8 të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.03/L-204 dhe i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-100 dhe Statutit të Komunës së Mamushës, Kuvendi i Komunës së Mamushës, në mbledhjen e mbajtur më 30/09/2014, miratoi

**RREGULLORE
MBI
TATIMIN NË PRONËN E PATUNDSHME PËR VITIN 2015**

I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME:

Neni 1

- 1.1 Kjo Rregullore cakton tatimin mbi pronën e paluajtshme dhe parashtron standartet dhe procedurat, të cilat duhet t'i respektojë Komuna gjatë administrimit të kësaj takse.
1.2 Të hyrat e vjela nga tatimi mbi pronë do të derdhën në llogari të komunës përkatëse dhe do të përdoren nga ajo në përputhje me Ligjin mbi menaxhimin financier publik.

Neni 2

Tatimi mbi pronën caktohet për tërë pronën e paluajtshme në Komunë, me përjashtim të pronës, e cila lirohet nga tatimi në përputhje me nenin 8 të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Baza tatimore dhe vlerësimi

Të gjithë pronarët – shfrytëzuesit e ndonjë prone i nënshtrohen pagimit të tatimit në pronë.
Baza tatimore do të jetë mesatarja e një metri katror (m^2) nga vlera qarkulluese e pronës së patundshme në treg, duke e shumëzuar me sipërfaqen e tërësishme të objektit.
Vlera e tregut përcaktohet duke u referuar të ardhurave që krijohen nga ajo pasuri, shpenzimeve të ndërtimit, vitit të ndërtimit, sipërfaqes së saj, kritereve të dhëna në fletaplikacionin mbi pronën dhe vlerën e bazuar në transaksionin më të ri

Neni 4

*Shkalla tati
more*

Shkalla tatimore për vlerësimin e shumës së detyrimit tatimor do të jetë si vijon:

| | |
|--|-------|
| - për pronën – rezidenciale | 0.16% |
| - për pronën- banuar..... | 0.16% |
| - për pronën - komerciale | 0.18% |
| - për pronën - industriale..... | 0.17% |
| - për pronën bujqësore | 0.15% |
| - për pronën e paluajtshme e braktisur dhe objektet e pabanuar | 0.15% |
| - për pronën të pa përfunduara | 0.16% |

në shumën e vlerës qarkulluese të pronës – objektit (bazës tatimore).

Neni 5
Zona tativore

Komuna e Mamushës përbhet nga dy zona tativore:

- Zona e parë përbëhet nga të gjitha pronat të cilat gjenden rrugës kryesore ose rrugë regionale brenda Mamushës.
- Zona e dytë përbëhet nga të gjitha pronat të cilat gjenden në rrugët anësore brenda Mamushës.

Mesatarja e vlerës qarkulluese e patundshmërisë, e bazuar në kriteret konform nenit 6. të kësaj Rregulloreje, caktohet si vijon:

| Zonat tativore | Zona e parë | Zona e dytë |
|--|--------------------|--------------------|
| për pronën – rezidenciale | 190 Euro | 160 Euro |
| për pronën- banuar | 190 Euro | 160 Euro |
| për pronën - komerciale | 380 Euro | 320 Euro |
| për pronën – industriale | 280 Euro | 250 Euro |
| për pronën bujqësore | 100 Euro | 80 Euro |
| për pronën e paluajtshme e braktisur dhe objektet e pabanuar | 100 Euro | 80 Euro |
| për pronën të pa përfunduara | 100 Euro | 80 Euro |

Neni 6

Tatimi mbi pronën është tatimi vjetor dhe paguhet në dy kiste të barabarta.

Detyrimi tatimor mbi pronën caktohet me Fature të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

Neni 7
Fushëveprimi

Tatimi mbi pronën sipas kësaj Rregulloreje, aplikohet për pronën private dhe për pronën e ndërmarrjeve në pronësi publike, shoqërore-shtetërore.

Neni 8
Lirimi nga tatimi mbi pronën e paluajtshme

8.1 Institucionet dhe organizatat e cekura më poshtë, do të lirohen nga tatimi mbi pronën për pronën që e posedojnë ose e shfrytëzojnë:

- a) Institucionet e Republikës së Kosovës;
- b) KFOR-i, UNMIK-u, EULEKS-i;
- c) Qeveritë e huaja, zyrat e huaja të ndërlidhjes, agjencitë qeveritare, organizatat ndërqeveritare, ose agjencitë e huaja donatore që kryejnë ndihma humanitare, punë rindërtimi, administrimi civil ose ndihmë teknike brenda Kosovës;

d) Organizatat joqeveritare me status të përsfimit të ndërsjellë publik, në përputhje me Rregulloren nr. 1999/22 të UNMIK-ut, të datës 15 nëntor 1999, mbi regjistrimin dhe punën e organizatave joqeveritare në Kosovë dhe

e) Institucionet fetare, të miratuara nga komuna në pajtim me administratën tatimore lidhur me pronën që shfrytëzohet për qëllime fetare;

8.2 Lirimi nga tatimi lidhur me pronën e paluajtshme, i përcaktuar në nenin 9.1, nuk vlen për pronarët e pronës së paluajtshme, përveç pronave të saktësuara në nenin 9.1.

8.3. Lirimi nga tatimi sipas nenit 8.1, nuk vlen kur:

- a) prona shfrytëzohet ose mbahet për shfrytëzimin e veprimtarisë komerciale dhe për krijimin e të ardhurave ose
- b) prona e zotëruar ose e shfrytëzuar nga një organizatë joqeveritare me status të përsfimit publik, nuk shfrytëzohet ekskluzivisht për qëllime të përsfimit publik.

Neni 9

Procedura e caktimit të tatimit mbi pronën dhe e drejta në ankesë

9.1 Tatimpaguesi, i cili nuk pajtohet me faturen e lëshuar nga Bordi Komunal, mund të ushtrojë ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të faturs nga Bordi Komunal për ankesa:

9.2 Deri më 30 nëntor 2013 në Komisionin për shqyrtimin e ankesave në Ministrinë e Financave.

9.3 Nëse Bordi Komunal nuk ka marr vendimin brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita në të cilën ankesa ishte dorëzuar, tatimpaguesi mund të ushtrojë ankesë në mënyrë drejtpërdrejtë në organet e përcaktuara në paragrafin 1. të këtij nenit, sipas kompetencës së tyre.

9.4 Tatimpaguesi i cili, nuk pajtohet me vendimin e lëshuar nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave në Ministrinë e Financave, mund të ankohet në Gjykatën Supreme brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve të pranimit të vendimit, deri më 30 nëntor 2013.

9.5 Nga 1 dhjetori 2012, gjykatë kompetente për të pranuar ankesa kundër vendimit të lëshuar nga organi kompetent për shqyrtimin e ankesave në Ministrinë e Financave, është Gjykata Themelore në Prishtinë.

9.6 Në procedurën e ankesës, për çështjet që nuk janë paraparë me këtë rregullore, gjen zbatim Ligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.03/L-204 dhe i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-100 si dhe Udhëzimi Administrativ nr. 5/2011.

Neni 10

10.1 Tatimpaguesi, pas marrjes së Faturës mbi caktimin e tatimit obligohet, që në afatin deri me 30 qershor 2013, ta paguajë këstin e parë të caktuar me Faturën e organit të Shkallës së Parë.

10.2 Pas kalimit të afatit prej sikurse në nenit 10.1, tatimpaguesit do t'i llogaritet kamata mujore prej 2 %, e më së shumti deri më 24 % në vit.

10.3 Qytetarët-tatimpaguesit nuk do të mund ta bëjnë regjistrimin (legalizimin) e pronësisë në bazë të kontratës për shitblerjen dhe nuk do të mund të kryejnë shërbime të tjera në organet kompetente lidhur me transaksionet mbi pronën derisa nuk kryejnë pagimin e tatimit në pronë të caktuar në bazë të Faturës të organit kompetent të paraparë me këtë Rregullore.

Neni 11

Pagimi i tatimit mbi pronën do të bëhet në llogarinë rrjedhëse të Komunës së Mamushës. Drejtoria për Buxhet dhe Financa, me Udhëzim të veçantë do të caktojë vendin e pagimit, mënyrën dhe procedurën tjetër të nevojshme për vjeljen e tatimit mbi pronën, apo edhe procedurën mbi vjeljen e dhunshme.

Neni 12

Inkasimi me metodat sankzionuese

Në rast të mospagimit të rregullt dhe me kohë të tatimit mbi pronën nga ana e obliguesit të tatimit të përcaktuar me Aktvendimin e organit kompetent të nxjerrë në pajtim me këtë Rregullore, do të bëhet kompensimi i borxhit duke përdoruar metodat sankzionuese që qojnë deri te pagimi i borxhit.

Neni 13

Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Në ditën e miratimit të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja e Kuvendit të Komunës së Mamushës nga data **26 Shtator 2013 numër 01 Nr. 009 - 13**, që ka të bëjë me çështjet që rregullohen me këtë Rregullore.

Neni 14

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Mamushës.

KUVENDI I KOMUNËS SË MAMUSHËS

01 Nr. 003 -14

Më 30/09/2014

Mamushë

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Mamushës

Fuat Taç

